

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE

ID 7.7, GËRMA C. TRAJTIMI DHE PËRPUNIMI I
MATERIALEVE TË NEVOJSHME PËR PRODHIMIN E
USHQIMEVE NGA LËNDËT E PARA NGA KAFSHËT (PËRVEÇ
QUMËSHIT)



Personi Juridik: "FIX PRO" SH.P.K.

Nipt: K83715001N

Adresa: Rr. Korçë – Dishnicë, Barç, Bulgarec, Korçë.

TABELË PËRMBLEDHËSE E PËRMBLEDHJES JOTEKNIKE		
NR.	PERMBAJTJA	FAQA
1.	PROFILI I OPERATORIT	3
1.1	KERKESAT PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS TE NJE PROJEKTI	5
1.2	PERSHKRIMI I INSTALIMIT	5
2.	QELLIMI	5
2.2	SUBJEKTI INVESTITOR	5
2.3	VENDNDODHJA E USHTRIMIT TE AKTIVITETIT	5
2.4	TE DHENA TEKNIKE TE AKTIVITETIT	5
3.	IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I SHKARKIMEVE KRYESORE NE MJEDIS	7
4.	IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS TE AKTIVITETIT	7
4.1	ANALIZIMI I NDIKIMEVE TE PRITSHME NE MJEDIS	11

1. Profili I operatorit

Shoqeria "Fix Pro"sh.p.k, eshte shoqeri e specializuar per: **Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë e nënprodukteve të mishit (sallam)**. Shoqeria eshte person juridik, me **Administrator Z. Nesti Tarusha**,. Shoqeria eshte e regjistruar ne Regjistrin Tregtar, prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT: **K83715001N**

Aktiviteti ka per qellim prodhimin, perpunimin, paketimin dhe ne fund tregtimin sallamit dhe produkteve te mishit, shume te rendesishem per tregun e konsumatorin shqiptare dhe te huaj. Te siguroi vlerësimin e përgjithshëm, te integruar dhe ne kohe te ndikimeve mjedisore, te projekteve ose veprimtarive qe kërkojnë te zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative ne mjedis.

Zhvillimi i ketij aktiviteti, permblihet ne perdorimin si lende e pare te mishit qe vjen nga jashte, duke u siguruar qe kjo lende e pare vjen me te gjitha kushtet dhe standartet e Bashkimit Evropian duke plotesuar te gjitha kushtet higjieno-sanitare. Ku me pas i nenshtrohet te gjitha proceseve kryesore deri ne produktin perfundimtar duke respektuar te gjitha hallkat e sigurise dhe cilesise ushqimore.

Nenshkrimi i nje sere konventash dhe miratimi i kuadrit ligjor per mjedisin ne funksion te tyre, detyron institucionet shteterore dhe subjektet fizike e juridike ti nenshtrohen disa procedurave vleresimi te impaktit te tyre para ndertimit dhe venies ne funksion te aktivitetit.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) eshte nje prej instrumentave parandalues dhe minimizues te ndikimit mjedisor dhe per projektin specifik, hartohet duke u bazuar ne kerkesat e zhvillimit te aktivitetit nga subjekti "XM" SH.P.K.

Ky raport perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit ne mjedis te aktivitetit te impiantit te prodhimit te betonit.

1.1 Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e zhvillimit te aktivitetit. Në procesin studimor të VNM përdoret informacioni dhe të dhënat teknike ekzistuese. Vleresimi i ndikimit ne mjedis hartohet qe ne fazen e projektidese per zhvillimin e aktivitetit, por gjithsesi edhe per aktivitete ekzistuese te cilat jane objekt i nje leje mjedisore ose i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Sipas kushtetutes se Republikes se Shqiperise, shteti siguron me te gjitha mjetet dhe mundesite qe ka, nje mjedis te paster dhe te sigurte per qytetaret dhe brezat e ardhshem.

1.2 Kërkesat Vlerësimit të Ndikimit në mjedis të një projekti

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Per vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

2. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

2.1 Qellimi i aktivitetit

Qellimi i funksionimit të këtij aktiviteti është prodhimi i sallamrave, duke marrë parasysh të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, gjithashtu duke minimizuar në mënyrën më të mirë ndikimet në mjedis që mund të lindin nga zhvillimi i këtij aktiviteti.

2.2 Subjekti investitor

Personi Juridik “FIX PRO” SH.P.K. do të ushtrojë aktivitetin në fushën e prodhimit të sallave sipas ID 7.7 GERMA C, referuar Ligjit 52/2020 “Për Lejet e Mjedisit”, për një ndryshim në Ligjin 10448 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar.

2.3 Vendodhja e aktivitetit

Aktiviteti që do të zhvillojë shoqëria ushtrohet në **Rr. Korçë – Dishnicë, Barç, Bulgarec, Korçë.**

2.4 Te dhena teknike të aktivitetit

Repartet kryesore në linjen teknologjike për prodhimin e nenprodukteve të mishit (sallamit) janë:

- Reparti i pritjes së mallit
- Reparti i parapergatitjes
- Reparti i prodhimit
- Reparti i pergatitjes së erzave
- Reparti i pjekjes së sallamit
- Reparti i ambllazhimit
- Reparti i ruajtjes së prodhimit
- Reparti i daljes së mallit

Proceset kryesore

Proceset kryesore që zhvillohen në fabriken e sallamit janë:

Pasi kontrollon lenda e parrë për temperaturën ngjyren e tij, futet në frigoriferet ngrirës që janë në temperaturën -2° grade Celsius dhe në frigorifere freskues. Malli është i kontrolluar dhe i shoqëruar me analizat përkatëse.

Procesi i manipulimit të lëndës së përpunuar.

Ky proces ka për qëllim mbajtjen e lëndës së përpunuar në parametra të caktuar në gjendje të ngrirë dhe realizohet nga frigoriferet ngrirës deri në -20°C . Mishi që do të përdoret për prodhimin e sallamit apo llojeve të tjera mbahet në frigorifere freskues. Lënda e përpunuar është mish kofshë, shpatull, muskul, pancetë e t.j. Pas këtij procesi të ngrirjes dhe freskimit, lënda e përpunuar nxirret dhe çohet në linjen e parapërgatitjes.

Procesi i parapërgatitjes.

Konsiston në çakullzimin e lëndës së përpunuar. Ky proces realizohet nga një frigorifer freskues $0-10^{\circ}\text{C}$, në temperaturën 4°C . Pas pastrimit lënda e përpunuar kalon në repartin e tranxhës, ndërsa mishi i fresket shkon në tavolinat e qerimit ku bëhet ndarja anatomike e mishit.

Linja e prodhimit të sallamit.

Proceset e punës në këtë linjë janë:

- a. Coptimi në tranxhë**
- b. Grirja**
- c. Kuterizimi**
- d. Mbushja**
- e. Procesi termik (Pjekja)**
- f. Ftohja**
- g. Paketim, etiketim**
- h. Magazinim**

- a.** Nga frigoriferet ngrirës mishi kalon në tranxhë nëpërmjet së cilës bëhet optimi.
- b.** Mbas copetimit, mishi kalon në procesin e grirjes. Grirja realizohet nga makina grirëse automatike. Procesit të grirjes i nënshtrohet edhe një pjesë e mishit që del nga ndarja anatomike.
- c.** Mbas këtij procesi mishi i grirë kalon në kuter. Kuteri është një pajisje automatike e cila punon me thika dhe vakum. Nga ky proces sigurohet homogjenizimi i mishit dhe përzierja e tij me erezat.
- d.** Mbushja, realizohet nga një mbushës automatik. Gjate këtij procesi realizohet standartizimi dhe lidhja e porcioneve të sallamit sipas llojit të sallamit. Materjali i përgatitur, vendoset në vagona, kalon në frigoriferin freskues për 6-10 orë për realizimin e procesit të lidhjes dhe më pas është i gatshëm për pjekje.



- e. Procesi termik, realizohet ne fura te cilat realizojne zierjen, pjekjen, tymosjen dhe ftohjen paraprake(dushin). Furat punojne me energji elektrike.
- f. Ftohja. Ky proces realizohet ne dhoma frigoriferike.
- g. Mbas ftohjes, sallami kalon ne procesin e etiketim, paketimit. Ky proces kryet nepermjet nje makine te posacme e cila punon ne vakum (hiqet ajri), dhe eshte nga teknologjite e fundit qe perdoren ne vendet e BE.
- h. Magazinimi i produktit te gatshem realizohet ne frigoriferin freskues dhe transporti per treg realizohet nga furgona te posacem per transportimin e tyre te cilet jane te pajisur me frigorifer ne temperature te caktuar per ruajtjen e produktit.
- i.

- **Lenda e pare**

Lenda e pare qe perdoret ne kete fabrike eshte mishi i gjedhit, mishi i derit etj. Lenda e pare sigurohet kryesisht nga importi dhe tregu i vendit dhe eshte e shoqeruar me certificate cilesie.

- **Lendet ndihmese.**

Per prodhimin e nenprodukteve te mishit (sallamit) perdoren nje sere material ndihmese, te cilat grupohen:

- Miks fosfatesh
- Kripera
- Mishelat e erezave

Lendet ndihmese vijne nga importi dhe jane te shoqeruara me flet analizat perkatese. Ne procesin e prodhimit si lende ndihmese konsiderohen edhe uji, energjia elektrike dhe termike, ambalazhi plastic dhe ai prej letre dhe kartoni.

Energjia elektrike. Energjia elektrike sigurohet ne te dyja format:

- rrjeti shperndares nepermjet kabines elektrike

Ky eshte nje aktivitet pa ndikime negative ne mjedis per arsye se:

-) Cikli i prodhimit është teresisht i mbyllur dhe në kontakte tepër minimale me elementët e mjedisit, pra eshte e mirepershtatur me mjedisin.
-) Nuk ka shkarkime ndotese ne ujerat siperfaqesore apo nentokesore, shkarkime te lendeve te demshme ne kanalizime, shkarkime te gazeve, pluhurave apo tymrave ne ajer apo gjenerim te lendeve me natyre ndotese ne toke.
-) Nga proceset e punes se ketij aktiviteti nuk gjenerohen zhurma. Te vetmet zhurma qe do te gjenerohen jane ato te ardhura nga funksionimi i aktiviteve te tjera perreth apo nga aktiviteti i punonjesve.
-) Mbetjet e gjeneruara gjate proceseve te punes apo nga konsumi, mbetje te ngurta urbane nuk konsiderohen mbetje te rrezikshme, nuk kerkojne trajtim apo asgjesim te specializuar dhe ne ambjentet e brendshme te aktivitetit hidhen ne kosha per tu depozituar pastaj ne vendet e caktuara per to nga Bashkia.
-) Ambjentet e brendshme te aktivitetit mbahen paster nga pastrueset qe jane te punesuara aty.

3. Identifikimi dhe Vleresimit I shkarkimeve ne mjedis

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nga zhvillimi I aktivitetit pritet qe te kete shkarkime minimale ne mjedis, duke iu referuar edhe natyres se tij. Disa nga shkarkimet e mundshme te ketij aktiviteti jane si me poshte vijon:

1. **Shkarkime ne ajer-** Gjenerime ne ajer nga operatori do te jene gjenerimi minimale te monitorueshme dhe brenda vlerave kufi. Gjithashtu ne kete grup gjenerimesh do te konsiderojme edhe mjetet te cilat depozitojne lenden e pare per perpunim apo produktin perfundimtar.
2. **Shkarkime ne uje-** Nga zhvillimi I aktivitetit nuk do te kemi shkarkime ne ujra.
3. **Shkarkimet ne toke-** Nga zhvillimi I ketij aktiviteti nuk do te kemi shkarkime ne toke. Mbetjet nga ky aktivitet do te evadohen ne menyren me te mire te mundshme.

4. Identifikimi dhe vleresimi i ndikimeve ne mjedis te aktivitetit

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm

Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake

Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore

Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit

Parimi i qasjes së integruar

Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit

Parimi "Ndotësi paguan"

Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut

Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe VKM Nr. 13, date 04.01.2013 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis" dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;

- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;

4.1 Ndikimet e pritshme ne mjedis nga zhvillimi I aktivitetit

Ndikimet e mundshme gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permbliohen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

NDIKIME NE TOKE	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi	Ndotja e tokes si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve apo ne rast te emergjencave te mundshme nga avarite ne sistem.
Lëvizja e automjeteve të transportit dhe përdorimi i makinerive në procesin e ndërtimit	Si pasojë e lëvizjes së makinerive: <ul style="list-style-type: none"> - do të kemi ngjeshje të tokës në sektorë të veçantë të saj, - mund të kemi rrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari me pasojë ndotje të tokës.

NDIKIME NE UJE	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi	Shkarkimet ne ujera vijne nga: <ul style="list-style-type: none"> - Ujerat e perdorur per ambjentet higjenosanitare te ambjentit te stafit
Lëvizja e automjeteve	Si pasojë e qarkullimit të mjeteve dhe përdorimit të mekanikës mund të kemi rrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari e mundshme me pasojë ndotje të ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

NDIKIME NE BIODIVERSITET	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi	Instalimi nuk parashikon ndryshime ne peisazh pasi operon ne nje zone te lokalizuar (godine), edhe ndikimin e kemi te lokalizuar.

NDIKIME NE AJER	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi i Impjantit te Prodhimit te Betonit Instalimi I Impjantit te Fraksionimit	Si pasojë e lëvizjes së automjeteve do të gjenerohen: <ul style="list-style-type: none">- zhurma,- gaze, pluhur ne ambjente pune- gaze nga djegia e karburantit të motorëve.

"FIX PRO" SH.P.K.
ADMINISTRATORI

Nesti TARUSHA